
	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b>  <b>Republika Kosova –</b>  <b>Republic of Kosovo</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b>  Opština Priština – Municipality  of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	--	--

<b>Datë/a:</b>	05.08.2020
<b>Për/ Za/ To:</b>	“RISAMONT” sh.p.k.; “Multi Bussines Group” sh.p.k.; “Granit.Hyseni” B.I.
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim përshqyrtim të kërkesës për rishqyrtim

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datave: 22.07.2020; 22.07.2020 dhe 23.07.2020 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik “RISAMONT” sh.p.k.; “Multi Business Group” sh.p.k.; “Granit.Hyseni” B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja dhe rikonstruimi i rrjetit për ndriçimin publik”**, me Nr. të Prok: **616 20 073 211** nxjerr:

## V E N D I M

1. **Aprovohet pjesërisht** të bazuara kërkesat për rishqyrtim të parashtruara nga Operatorët Ekonomik “RISAMONT” sh.p.k.; “Multi Business Group” sh.p.k.; “Granit.Hyseni” B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja dhe rikonstruimi i rrjetit për ndriçimin publik”**, me Nr. të Prok: **616 20 073 211**, kundër Njoftimit për Kontratë të AK –së, të datës 17.06.2020 të publikuar në ëeb-faqe të KRPP-së. të publikuar në ëeb-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmisimet në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja dhe rikonstruimi i rrjetit për ndriçimin publik”**, me Nr. të Prok: **616 20 073 211**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 17.06.2020 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja dhe rikonstruimi i rrjetit për ndriçimin publik”**, me Nr. të Prok: **616 20 073 211**

Me datë 22.07.2020, dhe 23.07.2020 Operatorët Ekonomik “RISAMONT” sh.p.k.; “Multi Bussines Group” sh.p.k.; “Granit.Hyseni” B.I. kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim me c’rast kanë parashtruar pretendimet e tyre për shkelje ligjore nga Autoriteti Kontraktues:

Pretendimet e OE: “RISAMONT” sh.p.k.:

*Pyetja nr.1:*

*Në paramasë dhe në parallogari janë kërkuar trupa ndriçues me diming control :*

1. *Trupat ndriçuese 104Ë,*
2. *Trupat ndriçues 50Ë,*
3. *Trupat ndriçues 42Ë*
4. *Trupat ndriçues 25Ë dhe*
5. *Trupat ndriçues 146Ë*

*Karakteristikat e kerkuara të trupave ndriçues janë të orientuara për prodhues të caktuar (PHILIPS) dhe sit ë tilla janë kritere diskriminuese dhe përjashtuese për prodhuesit e tjerë. Gjithashtu po që se I referohemi edhe karakteristikave teknike te kerkuara (lm/Ë), atëher kjo rezulton me produkte te orientuara direct te prodhuesi PHILIPS dhe ate duke ju referuar teknologjise se fundit e cila edhe ashtu eshte shume e shtrejt si dhe kriteret e instalimit dhe kushtet e montimit janë strikte dhe të përcaktuara nga vet prodhuesi.*

*Ju lutemi te kerkoni produkte me nje domen me te gjere te lm/Ë, fuqisë së trupave, jetëgjatësisë së trupave si dhe karakteristikat tjera te cilat deshmojne se kerkesat nuk jane diskriminuese dhe te orientuara.*

*Ju lutemi ti caktoni parametrat teknik standareve te aplikueshme per ndriçimimet publike, standarde keto qe percaktojne intensitetin e ndriçimit publik për çdo hapësirë, rrugë apo edhe lokacion që do të ndriçohet, perndryshe jemi te detyruar te kërkojmë sqarimet e ligjshmerise edhe ne instanca te tjera, gje qe kjo nuk do te jete ne dobi te asnjeres pale, pasi qe proceset vetem do te sterzgjaten dhe prolongohet ne teresi, pamvarsisht se ne fund do te percaktohen dhe definohen kriteret jo-diskriminuese dhe do te largohen ato favorizuese per OE te paracaktuar nga AK.*

*Ne kemi pranuar një përgjegje nga AK me dt.20.07.2020, mirëpo i njëjta në fakt nuk ka ndryshur asgje në aspektin teknik, përveç ndryshimit minor për fuqinë e trupave ndriçues, gjë që kjo nuk paraqet përgjegje profesionale në kërkesën tonë, mirëpo*

*paraqet një përgjegje shumë konfuze, aspak profesionale dhe fundja sa për të mos lën pa përgjegje.*

*Pyetja nr.2:*

*Në paramasë dhe parallogari keni kerkuar trupa ndriçues me intelegjent me diming control?*

*Duke pas parasyshë që natyra e projektit është mirembajtje, atëher cila është logjika e montimit të trupave ndriçues intelegjent në rrjetin egzistues I cili nuk është fare I intergruara në monitorim apo vëzhgim 7/24h, lëre më montimin e trupave ndriçues intelegjent ne shtylla egzistuese elektrike , ku kosto e trupit ndriçues është shumë fishë më e lartë se kosto e shtyllës elektrike. Me nje fjale, investimi I tillë konsiderohet teknikisht I paarsyeshmë dhe teknikisht jo profitabil.*

*Dallimi I çmimit të trupave ndriçues intelegjent me diming control dhe atyre pa diming control është teper I madh, kështu që ju lutemi ta caktoni sasinë indicative të trupave intelegjent që mendoni të instaloni.*

*Gjithashtu neve kërkojmë site vizite ne teren për me pa vendin e montimit të trupave ndriçues intelegjent si dhe marjen e rekomandimeve nga prodhuesi ne raport me vendin e montimit si dhe termat e garancionit që ata ofrojnë ne raport me kushtet e*

*montimit dhe monitorimit.*

*Ne kemi pranuar një përgjegje nga AK me dt. 20.07.2020, përgjegje kjo aspak profesionale.*

*Vet fakti që ju si AK thoni që nuk keni kerkuar trupa ndriçues intelegjent, kjo lën për te nenkuptuar se ju as vet nuk e dini se çfar jeni duke kërkuar apo edhe për shkak të situatave që do të krijohen në të ardhmen pas nënshkrimit të kontratës me OE-të të cilve ju i keni përgadite terrenin, atëher doni të silleni me inferioritet dhe të lëni paqartësi në mënyrë që pas nënshkrimit të kontratës me OE të paracaktuar, ta keni më të lehtë lëvizjen me pozicione.*

*Ne kemi kërkuar të caktohen sasitë indikative pasi që ju keni ofruar variante të pozicioneve me çmime kontraverse ku raporti i çmimeve ne mes varianteve të pozicioneve është 1/15, respektivisht deri 1/20.*

*Ju lutem ti definoni sasitë indikative?*

*Ne kemi kërkuar site vizite ne teren për me pa vendin e montimit të trupave ndriçues intelegjent si dhe marjen e rekomandimeve nga prodhuesi ne raport me vendin e montimit si dhe termat e garancionit që ata ofrojnë ne raport me kushtet e montimit dhe monitorimit. Gjithashtu gjat vizites do të realizohen edhe konsultat profesionale*

*me stafin profesional te AK ne menyre qe ne si OE dhe ju si AK te qartesonini sa me mire punet qe duhet te realizohen dhe lokacionet e realizimit te tyre.*

*Përgjegjja e juaj është:*

*A thua per neve si OE pjesmarrës a është duke paraqitur probleme situata pandemike me COVID-19, ku edhe tek ne situata pandemike ka shkaktuar probleme te theksuara ne organizim te punes, organizim te stafit si dhe ne pune me staf te reduktuar per shkak te situates pandemike COVID-19.*

*Duke ju referuar situatës pandemike COVID-19 në të cilën jemi, atëher edhe po kërkojmë nga AK që të lehtësoj dhe të mos i komplikoj kriteret përzgjedhëse për aplikim, njëshu edhe të qartësojë dhe të mos diskriminoj OE pjesmarrës, pasi që situata pandemike në të cilën jemi duke operuar, është situatë e njëjtë si për AK njëashtu edhe për OE pjesmarrës.*

*Pyetje administrative për tu sqaruar:*

*Ne kemi pranuar një përgjegje nga AK lidhur me pyetjet dhe shqetësimet tona qe i kemi bere dhe po i bëjmë në kohë pandemie, ndërsa kemi pranuar një përgjegje nga AK sikurse gjithçka është duke funksionuar në kushte normale dhe se bizneset nuk ndodhen në kurfar vështërsie të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, gjë që edhe vendosja e kërkesave shtesë që bartin kosto financiare dhe kërkojnë kohë për tu realizuar, nuk paraqet problem për ne!*

*Përgjegjja e juaj ishte (një pjesë nga përgjegjja):*

*Nga vet përgjegjja juaj rrjedh edhe kërkesa jonë për lehtësim të kritereve, respektivisht mos vendosjen e kritereve diskriminuese për OE pjesmarrës.*

*Si është e mundur posedimi me dokumentin e kërkuar në kohë pandemike, zyrtarisht nga muaji Mars për të vazhduar edhe në këto momente kur po ju kërkojmë reflektim në situatën në të cilën jemi:*

4. *Operatorët Ekonomik duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin sipas kërkesave të Ligjit 04 L-161 për Siguri dhe Shëndet në punë Operatorët Ekonomik duhet të dëshmoj raportin e vlerësimit të rriskut për të gjitha pozitat e organogramit dhe organizimit të kompanisë nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.*

*ndërsa aktiviteti i prokurimit inicohet në muajin korrik?*

*Në këtë kohë virusi COVID-19 po ju paraqet edhe juve problem në funksionim, duke punuar me staf te reduktuar si dhe duke punuar në mungesë të stafit profesional për shkak të infektimit me COVID-19, atëher cilat janë përgjegjet e juaja si AK për OE pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit?*

*Janë përgjegje aspakt reflektuese me situatën pandemike në të cilën gjendemi.*

*Pajisja me dokumente te tilla cfar ju po kerkoni si AK, ne kushte normale kërkon të pakten tre muaj, duke perfshire mbajtjen e trajnimeve te stafit, trajnime keto qe kane programin e vet si material ashtu edhe ate kohor.*

*Ndërsa në kohë pandemike, pajisja me keto certifikata te pakten kerkon dyfishin e kohës së punës në kushte normale.*

*Sipas njoftimit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, shfuqizimi i vendimeve te kohes se pikut te pandemis është bër me dt.12.06.2020, ndërsa inicimi i kësaj procedure të prokurimit është bërë me dt.17.06.2020.*

*Ju lutemi, si është e mundur të pajiset një OE me dokumentin e kerkuar nga AK vetëm për 5 ditë në kohë pandemike COVID-19?, përveç në rast kur ky kriter është kriter i orientuar për OE të paracaktuar dhe diskriminues për OE tjerë pjesmarrës.*

*Po që se OE të interesuar per pjesmarrje ne kete aktivitet te prokurimit do te ishin te njoftuar nga ana e AK permes njoftimit paraprak, ateher do te kishin kohe me shume per pergaditje me dokumentacionin e kerkuar, respektivisht kriterin apo kritere keto që nuk janë të standardizuara dhe kërkuara më heret.*

*Të nderuar ju lutemi ne ju kemi kërkuar lehtësimin e masave për biznese sikurse që tërë shteti është duke ndihmuar bizneset ne këtë situatë pandemike, mirëpo jo krijimin e vështersive për kompani dhe orientimin e projekteve drejt prodhuesve dhe kompanive të caktuara.*

*Pyetjet tona janë ende aktive dhe kërkojnë reflektim dhe mirëkuptim nga ana e AK.*

1. Përshkrimi i nenit "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale", respektivisht:

*Pika 4. Operatorët Ekonomik duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin sipas kërkesave të Ligjit 04 L-161 për Siguri dhe Shëndet në punë*

*Operatorët Ekonomik duhet të dëshmoj raportin e vlerësimit të rrishtit për të gjitha pozitat e organogramit dhe organizimit të kompanisë nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.*

*Duke pas parasysh situatën në të cilën veprojnë (situatë pandemike COVID-19), atëherë edhe dokumentacionet e kërkuara, thuhet se është e pamundur për tu siguruar, pasi që kjo kërkon kohë dhe kushte për mbajtjen e ligjeratave si dhe trajnimeve perkatese për tu pajisur me raportin e vlerësimit të rrishtit. Gjithashtu rrite shpenzimet operative të kompanive, ashtu të përkeqësuar nga situata pandemike.*

*Duke ju referuar situatës pandemike COVID-19, atëherë të gjitha aktivitetet e kompanive janë pergjysmuar në staf si dhe është thuhet se pamundur të meren këto certifikime, apo të njëjtat mundë të meren për një kosto shumë të lartë e që është kosto e papërbalueshme për bizneset në këto momente pandemie COVID-19*

*Ne anën tjetër, të njëjten kërkesë të AK e mbulojnë certifikatat ndërkombëtare ISO, siç është ISO 45001-2018 SISTEMI I MENAXHIMIT TË SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË.*

*Duke ju referuar të gjitha këtyre që u than më lartë, atëherë lusim AK që të përkrah dhe mbështet OE pjesmarrës në këto rrethana pandemike COVID-19 dhe të lehtësojë kriteret përzgjedhëse duke zëvendësuar të njëjtat me certifikatat ndërkombëtare si të njohura apo edhe të heq këto kriterë si kriterë përzgjedhëse.*

*Ju lutemi ta largoni apo të zëvendësoni kërkesën e njëjte me standard perkates ISO, përndryshe jemi të detyruar të kërkojmë sqarimet e ligjshmerise edhe në instanca të tjera, gje që kjo nuk do të jete në dobi të asnjeres pale, pasi që proceset vetem do të sterzgjaten dhe prolongohet në teresi, pamvarsisht se në fund do të percaktohen dhe definoohen kriteret jo-diskriminuese dhe do të largohen ato favorizuese për OE të paracaktuar nga AK*

*Ne po ju lusim për mirekuptim dhe lehtësim të masave pa e rrezikuar fare sigurinë e procesit, përndryshe jemi të detyruar të kërkojmë sqarimet e ligjshmerise edhe në instanca të tjera, gje që kjo nuk do të jete në dobi të asnjeres pale, pasi që proceset vetem do të sterzgjaten dhe prolongohet në teresi, pamvarsisht se në fund do të percaktohen dhe definoohen kriteret jo-diskriminuese dhe do të largohen ato*

## 2. Pretendimet e OE: “Multi Business Group” sh.p.k.

Ne e parashtrojmë këtë kërkesë për rishqyrtim sepse në dosje të tenderit shkruan 4. Operatorët Ekonomik duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin sipas kërkesave të Ligjit 04 L-161 për Siguri dhe Shëndet në punë nuk e kuptojmë arsyen e kërkesës së një dokumentacioni të tillë, pasi që këtë në mënyrë identike e pasqyrojnë çertifikatat ISO 14001 dhe OHSAS 18001, të cilat secili operator ekonomik serioz duhet t'i ketë.

### KËRKESA E PARË PËR SQARIM:

Edhe pse gjatë përshkrimit të ndriçuesve rrugor të teknologjisë LED përpiluesi i paramasës nuk ka dhënë emrin e ndonjë prodhuesi, megjithatë nga karakteristikat e përshkruara teknike vërehet lehtë se këto karakteristika janë shumë të ngjashme apo më mire të themi identike me karakteristikat e prodhuesit të njohur të këtij lloji të ndriçuesve.

Fitohet përshtypja se nga ËEB-faqja e këtij brendi të njohur janë kopjuar karakteristikat teknike dhe janë vendosura në paramasë. Fjala është për prodhuesin e mirënjohur PHILIPS.

Për hirë të korrektësisë ndaj operatorëve ekonomik dhe korrektësisë ndaj prodhuesve, sepse ligji dhe rregulloret në fuqi e definojnë në përpikëri këtë pike, mendojmë që duhet të zgjedhen karakteristika teknike

të ndriçuesve kualitative, por që përfshinë gamë të gjerë të produkteve të kësaj natyre.

### KËRKESA E DYTË PËR SQARIM

Në dosje të tenderit kërkohet siguria e tenderit të jetë nga 1000€ për secilin LOT do të thotë, në total 6000€ për operatorin ekonomik që konkuron në të gjashtë LOT-et.

Duke e marrë parasysh se pavarësisht konkurimit eventual të operatorëve ekonomik në të gjitha LOT-et, operatorët ekonomik mund të shpërblehen vetëm me një LOT, do të ishte e udhës që vlera e sigurimit të jetë vetëm 1000€.

### KËRKESA E TRETË PËR SQARIM

Sistemi i ndriçimit publik në Komunën e Prishtinës, përveç ndërrimit gjatë viteve të ndriçuesve konvencional me poq të natriumit dhe të zhivës në njërën anë me ndriçues të teknologjisë bashkëkohore LED në anën tjetër nuk ka pësuar ndryshime tjera, të cilat lidhen me vendosjen e sistemit intelgjent të ndriçimit publik në qytetin dhe në fshatrat e Prishtinës.

Në kuadër të sistemit dhe rrjetit ekzistues të ndriçimit të Prishtinës nuk janë të instaluar elementet e nevojshme për funksionimin e sistemit intelgjent dhe mundësisë së rregullimit dhe dirigjimit nga distanca.

Pretendimet e OE: "Granit Hyseni" B.I. janë poashtu të njëjta me pretendimet e dy operatorëve të lartcekur.

## Baza Ligjore

AK në bazë të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik, Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik si dhe kritereve të dosjes së tenderit jep përgjigjet si në vijim:

1. Sa i përket specifikimeve teknike në paramasë për trupa intelgjent, përveq sqarimeve të mëhershme që i kemi dhënë, në këtë sqarim kemi larguar pozicionet me specifika të kualitetit të lartë për trupat ndriques. Në attachment kemi bashkangjitur paramasën me përmirësime pa këto pozicione.
2. Site vizita nuk ka nevojë të bëhet ngase kemi larguar pozicionet e trupave me kualitet të lartë dhe nuk ka nevojë të bëhen vizita në teren, ngase punët realizohen sipas nevojave dhe defekteve që paraqiten në teren në sistemin e rrjetit të ndriqimit publik, në dosje janë dhënë listat e rrugëve për secilën loto.
3. Përshkrimi teknik dhe specifikimet teknike janë në kompetencë të kërkuetit, prandaj ne kemi specifikuar në përshkrimin e paramasës në pozicione për njësi. Pozicionet në paramasë janë dhënë me çmim për njësi, varësisht nga nevoja që paraqitet në teren të kryhen pozicionet e nevojshme. Prandaj edhe çmimet nga OE jepen për njësi dhe kjo mbetet që OE të ofrojnë çmimet në oferta.
4. Autoriteti Kontraktues ka vendosur që të bëjë paranimin edhe certifikatave ISO STANDARD ISO 45001-2018 SISTEMI I MENAXHIMIT TE SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË. Certifikata ISO STANDARD duhet të jetë valide për vitin 2020-2021 dhe të dëshmohet edhe me ueb linkun zyrtar të kompanisë licencuese ku Autoriteti Kontraktues do të mund të verifikoj origjinalitetin e ISO STANDARDIT dhe validitetin e saj. Nesë Operatori Ekonomik nuk e ofron ëb-linkun për verifikim të ISO STANDARD direkt nga Kompania licencuese me automatizëm do të eliminohet. Poashtu Operatorët Ekonomik duhet të dëshmojnë vlefshmërinë e riskut me raport zyrtar lidhur me licencimin e tyre me ISO STANDARD 45001-2018.



**5. Autoriteti Kontraktues edhe në sqarimin e fundit ka dhënë përgjigje që Operatorët Ekonomik duhet të bëjnë sigurimin e tenderit për të gjitha Lotët vetëm në vlerë prej 1000 euro dhe kjo mbetet në fuqi.**

Andaj Komuna e Prishtinës kujdeset që maksimalisht të jenë në zbatim të parimit të transparencës, ligjshmërisë, efikasitetit dhe eficiencës.

**Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.*

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**

---